



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
GJIROKASTËR  
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE  
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TE HUAJA

**STRATEGJIA E ZHVILLIMIT  
TË DEPARTAMENTIT TË GJUHËVE TE HUAJA  
PËR PERIUDHËN 2020 - 2025**

Përgjegjësi i Njësisë bazë  
Prof.asoc. Harallamb Miçoni

Gjirokastër, më 04.04.2019





**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
FAKULTETI EKONOMIK  
DEPARTAMENTI I POLITIKAVE EKONOMIKE DHE TURIZMIT**

# **Strategjia e Zhvillimit 2020-2025**

**Gjirokastër, Nëntor 2019**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS  
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISE DHE KIMISE  
GJIROKASTËR

**STRATEGJIA E ZHVILLIMIT  
AFATMESËM DHE AFATGJATË**

**DEPARTAMENTI I BIOLOGJISE DHE KIMISE**

Gjirokaster,



## PËRMBAJTJA

I. Hyrje	3
II. Strategjia e zhvillimit afatmesem dhe aftatgjate te Departamentit te Biologjise dhe Kimise	3
1.Vizioni	3
2.Misioni	4
3.Vlerat	4
4.Qellimi	4
5.Prioritet strategjike	5
6.Kapitali human dhe sistemet mbeshtetese	5
7.Nderveprimet jashte fushes akademike	5
III. MESIMDHENIA	6
1.Logjistika	6
2.Metodika e mesimdheneies	6
3.Raporti sstudent-pedagog	7
IV.KERKIMI SHKENCOR	7
V.SHERBIME PER KOMUNITETIN	7



## I. HYRJE

Departamenti i Biologjise dhe Kimise ka zhvilluar dhe zhvillon gjithe aktivitetin e vet ne perputhje me politikat arsimore kombetare dhe me vizionin strategjik te Universitetit te Gjirokastres. Strategjia e tij është konceptuar dhe miratuar në trajtën e dokumentit zyrtar bazuar ne Ligjin e Arsimit te Larte te vitit 2015. Ajo do te sherbeje si një udherefyes per konsolidimin dhe zhvillimin e Departamentit ne te ardhmen.

## II. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT AFATMESËM DHE AFATGJATË TË DEPARTAMENTIT TE BIOLOGJISE DHE KIMISE

Departamenti i Biologjise dhe Kimise, Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër, ka në përbërje te tij grupet mesimore dhe kerkimore si me poshte:

- Grupi mesimor - kerkimor i Biologjise
- Grupi mesimor - kerkimor i Kimise dhe metodikave te mesimdhenies

### 1. Vizioni

Departamenti i Biologjise dhe Kimise ka zhvilluar dhe zhvillon strategjine e vet ne kuader te veprimtarise strategjike te UGJ e cila synon te pershtatet e t'i paraprijë zhvillimit ekonomik e shoqeror te vendit. Ai synon te kthehet ne një qender te fuqishme per arsimimin dhe kerkimin shkencor i orientuar nga kerkesat qe ka sot tregu i punes, reformat social-ekonomike si dhe standartet e reja te integrimit evropian.

- ✓ *Vizioni: Te jete një ndër departamentet me të mira te Universitetit dhe pike referimi per të rinjtë e gjithë Rajonit Jugor duke ju ofruar atyre kushte dinjtoze ne mesimdhenie dhe kerkimin shkencor.*

### 2. Misioni

Misioni i Departamentit te Biologjise dhe Kimise lidhet me krijimin, zhvillimin, transmetimin dhe mbrojtjen e dijeve përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe mbeshtetjes institucionale. Fokusi i punes se tij ka qenë dhe mbetet formimi profesional cilësor dhe bashkekohor i studenteve ne perputhje me nevojat e tregut te punës ne rang kombetar dhe rajonal.

### 3. Vlerat

- Standartet akademike: Per arritjen e misionit te vet Departamenti i Biologjise dhe Kimise synon te rise aftesite profesionale te stafit te tij nepermjet perfshirjes ne procesin e fitimit te



- ✓ Krijimin e mardeheneve partneriteti me universitetet te hauja si domos me ato qindje.
- ✓ Fitimit te titujve dhe gradave shkençore.
- ✓ Kualifikimin e vazhdueshem te stafit akademik nepermjet perfsirjeve ne procesin e krijuar dherë.
- ✓ Perfsirjen me te madhe te stafit akademik dhe studenteve ne projekte kombetare apo ndekombetare.
- ✓ Pergatitjes se specjalisteve te ardhshem.
- ✓ Ciljen e programit "Master Shkençor" ne funksion te rritjes se kerkimt shkençor dhe dha menaxhimin e mjeđisit
- ✓ Hapjen e programeve te reja, me karakter profesional, te fokusura ne mbrojtjen mesimdheneve.
- ✓ Permisim dha rinnovimin e kurikulave ne funksion te rritjes se ciljeve se infrastruktureve mesimdheneve.
- ✓ Rritjen e ciljeve se studienteve nepermjet permisimi te metodologjise dha mesimdheneve.
- ✓ Prioritet strategjike te Departamentit te Biologjisë dha kimise janë ne harmoni te plete me Strategjinë Komboetare te Zhvillimit te Arsimit te Larte, dhe fokusohen në:

## 5. Prioritetet Strategjike

Departamenti i Biologjisë dha kimise, mbetet i angazhuar në përgatitjen dha formimin kerkesat dha standarde te reja te tregut te punes ne rang komboetar, si dha sfidat e cilosor te studenteve si mesues apo specjaliste te ardhshem, per te perballuar me sukses integrimit evropian.

## 4. Qellimi

- Punësimi: Me programin aktual te studimit dha me programet e reja te studimit ne mund te mbeshitet gjithmonë ne parimet e etikës dha respektit reciprok.
- Udhje me e ngsjchte me studentet: Departamenti i Biologjisë dha kimise do te synojne arritet duke pershtatur permbylljen e ketyre programeve me nevojat reale te tregut te te happen ne te ardhmen synohet rritja e mundesive per punesim e studenteve. Ky do te arritet duke pershtatur permbylljen e ketyre programeve me nevojat reale te tregut te punes.
- Punësimi: Me programin aktual te studimit dha me programet e reja te studimit ne mund per krijimin e një mjeđisi me midesor dha me motivues ne funksion te perveteşimit efikas te njoħurive shkençore dha formimit te tyre profesional. Ky baskepunim do ugritjen ne një nivel me te lart te mardeheneve baskepunuese me studentet,

titutive dha gradave shkençore kjo do te arritet nepermjet mbeshetjet dha krimi te një mjeđisi sa me te pershtashem puna nega ana e Universitetit dha Departamenti.

- ✓ Krijimin e një bashkepunimi te qendrueshem me të gjithë aktoret lokale te interesuar për çështje apo probleme të ndryshme me interes reciprok.

## **6. Kapitali human dhe sistemet mbeshtetese:**

- Departamenti i Biologjise dhe Kimise është perpjekur dhe perpiqet të krijojë kushte të favorshme për stafin e vet, qofte në aspektin human qofte në atë profesional, ne funksion te mbarevajtjes se punës se tyre akademike.
- Terheq personel akademik të kualifikuar në fushën e mesimdheneve dhe kerkimit shkencor.
- Mbështet studentë të talentuar dhe të motivuar duke ju ofruar atyre mundesi dhe kushte për të arritur rezultate të larta.
- Mbështet dhe ndihmon personelin ndihmës akademik per mirembajtjen e permiresimin e infrastrukturës laboratorike.
- Mbështet të gjithë personelin e administratës se universitetit që vihet në dispozicion te zgjidhjes se problematikave të ndryshme që kane lidhje me mbrevajtjen e procesit mesimor dhe kerkimit shkencor.

## **7. Nderveprime jashtë fushës akademike**

- Departamenti i Biologjise dhe Kimise synon:
- Te krijojë një bashkepunim të vazhdueshem me sektorin publik dhe privat për çështje me interes reciprok në fushat e arsimit, shkences, mbrojtjes dhe manaxhimit të natyrës, mjedist urban etj.

### **III. MËSIMDHËNIA**

Ne fushën e mesimdheneve Departamenti i Biologjise dhe Kimise synon :

- Te konsolidoje dhe zhvilloje me tej programet ekzistuese të studimit të ciklit të parë dhe të dytë.
- Te fitoje programe të reja studimi .
- Te permiresoje dhe rinovoje kurikulat duke u konsultuar me literaturën bashkekohore vendase dhe te huaj.
- Te permiresoje metodologjine e mesimdheneve duke u konsultuar me literaturën bashkekohore vendase dhe te huaj.
- Te siguroje dhe permiresoje infrastrukturen ne auditore dhe laboratore.
- Te pergatise tekste të reja universitare ne bashkepunim me pedagogët e Universiteve të tjera.
- Te behet një qender per kualifikimin profesional te mesuesve te rajonit jugor

Strategjia e zhvillimit të Departamentit te Biologjise dhe Kimise



## **1. Logjistika e Departamentit**

Ruajtja dhe permiresimi infrastrukturës si faktor kryesor ne rritjen e cilesise se mesimdhënies dhe kerkimit shkencor është mbajtur gjithmonë në qendër të vëmendjes nga ana e Departamentit i Biologjise dhe Kimise. Per sa me siper synojme:

- Përmirësimiin dhe pasurimin e vazhdueshem te bazës materiale te laboratoreve.
- Celjen e laboratoreve te reja ne mbeshtetje te programeve te reja te sudimit.
- Instalimin ne te gjitha auditoret te mjeteve per komunikimin interaktiv.
- Zyra pune ku te punojne te pakten tre pedagoge.
- Ngritjen e nje salle, me infrastrukture te kompletuar, me destinacion kerkimin shkencor.
- Ngritjen e bibliotekes se Departamentit ne dispozicion te studenteve dhe pedagogeve.
- Ngritjen e nje ambjenti me logistikën e nevojshme per mirembajtjen dhe riparimin e mjeteve dhe paisjeve laboratorike

## **2. Metodika e mësimdhënies**

- Përmirësim dhe pasurim me elementë bashkëkohorë te metodikës së mësimdhënies per te nxitur te mesuarit aktiv te studenteve ne funksion te krijimit dhe zhvillimit te mendimit kritik,logjikes, shprehive praktike dhe zgjidhjeve racionale.

## **3. Raporti student - pedagog**

- Të ruajme raportin student - personel akademik ne mesataren e BE (1:20).
- Të shtojme numrin e studentëve ne menyre graduale dhe ne perputhje me rritjen e kapaciteteve ne infrastrukture dhe staf akademik duke ruajtur standartet dhe cilesise se mesimdhënies.

## **IV. KËRKIMI SHKENCOR**

Departamenti i Biologjise dhe Kimise ka një pervoje te mire ne kerkimin shkençor. Stafi i tij eshte perfshire ndër vite ne hartimin dhe realizimin e disa projekteve shkencore ne nivel lokal,kombetar dhe nderkombetar. Rezultatet e tyre jane prezantuar ne shume konferanca dhe botuar ne shume revista shkencore, vendase dhe te huaja. Kerkimi shkencor ka qene dhe mbetet prioritet ne strategjine e Departamentit tone me ndikim te rendesishem jo vetem ne rritjen e aftesive profesionale te stafit,cilesise se mesimdhënies por dhe pasurimit te dhenave per biodiversitetin ne teritorin e Shqiperise. Duke qene se sfidat qe na presin jane shume me te medha, ne te ardhmen synojme:

Strategjia e zhvillimit të Departamentit te Biologjise dhe Kimise



- Te krijojme një mjedis te favorshem që nxit, motivon dhe perkrah kerkimin shkencor.
- Te rrisim pjesemarrjen e stafit ne hartimin dhe realizimin e projekteve te perbashketa ne nivel lokal kombetar apo nderkombetar.
- Te rrisim pjesemarrjen dhe kontributin e studeneve ne hartimin dhe ralizimin e projekteve shkencore.
- Te permiresojme dhe pasurojme te gjithe infrastrukturen e nevojshme ne mbeshtetje te kerkimit shkencor.
- Te rrisim pjesemarrjen e stafit akademik ne hartimin e politikave rajonale apo kombetare qe mbeshtesin kerkimin shkencor.
- Te rrisim kontributin shkencor te stafit nepermjet pjesemarrjes ne kongrese shkencore kombetare apo nderkomebatere si dhe numrin i artikujve te botuar ne revista prestigjoze shkencore (me IF).
- Te rrisim numrin e pedagogeve qe perfshihen ne fitimin e titujve te larte akademike(Prof.asoc.Dr., Prof.Dr.)

## V.SHËRBIMET PËR KOMUNITETIN

Departamenti i Biologjise dhe Kimise synon të kete një ndikim te fuqishem ne zhvillimin rajonal jo vetem nepermjet pergamitjes se mesuesve dhe specialisteve te afte por gjithashtu dhe nepermjet bashkepunimit me komunitetin e gjere ne fusha te ndryshme qe permiresojne cilesine e jetes se tyre si psh: ne mbrojtjen dhe menaxhimin e biodiversitetit, te monumenteve te natyres ,parqeve kombetare dhe zonave te mbrojtura, te mjedisit urban, zhvillimit te agroturizmit,ekoturizmit, etj.

**Pergjegjes i Njesise Baze**

**Prof. asoc. Dr. Sadik Malo**



## PËRMBAJTA

- HYRJA
- MISIONI, VIZIONI DHE PRIORITETET STRATEGJIKE
- RISTRUKTURIMI I PROGRAMeve EKZISTUESE TË STUDIMIT DHE HAPJE PROGRAMESH TË REJA
- MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT
- KËRKIMI DHE STUDIMET SHKENCORE
- LIDHJET KOMUNITARE DHE KOMBËTARE
- ANALIZA SWOT



## HYRJE

Procesi i transformimit të arsimit sipas modeleve të sotme më të përparuara, ka disa vite që ka filluar, sepse vetëm nëpërmjet modeleve bashkëkohore të mësimdhënies garantohet edhe suksesi. Sigurisht që këto qasje kanë përfshirë edhe institucionet e arsimit të lartë.

Si pjesë e Fakultetit të Ekonomisë dhe Universitetit “Eqrem Çabej”, edhe Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit (DPET) ka bërë dhe do vazhdojë të bëjë përpjekje për t'u përshtatur me këto zhvillime duke u bërë pjesë e ideve të reja, hartimit dhe zbatimit të programeve mjaft të përparuara për zhvillimin e shoqërisë.

Pedagogët të cilët janë pjesë e këtij Departamenti kanë vazhduar të përmirësojnë gjithnjë e më shumë përgatitjen e tyre profesionale duke bashkepunuar edhe me kolegë të Departamenteve të tjera jo vetëm pjesë e Fakultetit Ekonomik dhe Universitetit të Gjirokastrës, por të universiteteve të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Sot, jetojmë në epokën e ndryshimeve të shpejta ku ka ndryshuar mendësia e mundësia e individit dhe ekonomive, kur mbizotëron shpërndarja e shpejtë e informacionit dhe vendi ka nevojë për individë krijuar, me mendim kritik, që ju japid zgjidhje problemeve komplekse dhe e menaxhojnë ndryshimin në mënyrë eficiente. Prandaj parë në këtë këndvështrim, DPET ka hartuar një Strategji Zhvillimi e cila do të ndihmojë në integrimin më të mirë të arsimit universitar me shoqërinë si në aspektin lokal ashtu edhe në atë rajonal e kombëtar.

Strategjia afat-mesëm e DPET është hartuar duke marrë parasysh sugjerimet e grupeve të interesit (stafit akademik dhe studentëve), është ndikuar nga prirjet kryesore të zhvillimit të arsimit të lartë në Evropë dhe në botë, por gjithmonë ajo është hartuar si pjesë e Strategjisë së Fakultetit Ekonomik dhe Universitetit të Gjirokastrës



## MISIONI, VIZIONI DHE PRIORITETET STRATEGJIKE

### ➤ Misioni

DPET është i organizuar si një nga tre njësitë bazë të Fakultetit Ekonomik (FE).

Misioni i DPET përqëndrohet në krijimin e kapaciteteve reale për shoqërinë dhe ekonominë duke patur në fokus kryesisht sektorin e Turizmit. Pra ky mision është i përqëndruar në përgatitjen e specialistëve të lartë të ekonomisë dhe në përgatitjen e specialistëve të nivelit më të ulët nëpërmjet programit 2 - vjeçar me karakter profesional. Gjithashtu, ky departament synon të shërbejë edhe si një qendër e rëndësishme kërkimore-shkencore në rajon.

### ➤ Vizioni

DPET synon të përshtatet e t'i paraprijë zhvillimit shoqëror e ekonomik të vendit. Ai synon të kthehet në një qendër të edukimit të vazhdueshëm për Rajonin e Jugut. DPET do të vazhdojë të jetë qendër e fuqishme për arsimimin dhe kërkimin shkencor të orientuar nga tregu i punës, nga reformat social-ekonomike dhe nga standartet e reja të integrimit europian.

### ➤ Prioritetet Strategjike

Mësimdhënia dhe kërkimi shkencor do të janë objektivi kryesor në DPET, duke u përpjekur që t'i paraprijë dinamikës së ndryshimeve dhe nevojave të së ardhmes së shoqërisë dhe ekonomisë së vendit tonë. Kjo do të arrihet nëpërmjet:

- Zhvillimit të vazhdimishëm të burimeve njerëzore me synim përmiresimin e rritjen e kulturës së cilësisë;
- Zgjerimit të shërbimeve në kuadër të zhvillimit të FE dhe UGJ
- Rritjes në mënyrë graduale të nivelit të punës shkencore dhe bashkëpunimit me universitet e institucionet partnere.
- Orientimit të veprimtarisë se DPET për zhvillimin e rajonit të Gjirokastrës;
- Edukimit të studentëve të një mendimi krijues, të lirë, të pavarur dhe qytetar akademik.



## **RISTRUKTURIMI I PROGRAMEVE EKZISTUESE TË STUDIMIT DHE HAPJE PROGRAMESH TË REJA**

Të gjitha vlerësimet e viteve të fundit e kanë renditur papunësinë si një nga problemet kryesore të vendit tonë. Si rrjedhim, qeveria shqiptare me të drejtë e ka vënë fokusin te punësimi dhe zhvillimi cilësor i forcës së punës, në përputhje me vizionin dhe Direktivat e Bashkimit European, Strategjisë Evropiane të Punësimit 2020 si dhe kërkesave për integrimin europian të Shqipërisë. Në këtë aspekt njësitë bazë pranë UGJ-së janë përpjekur që krahas programeve ekzistuese të bëjnë edhe riorganizime dhe hapje të programeve të reja.

Është celur tashmë programi i ri 2-vjeçar i orientuar në kualifikimin profesional, si një nga mundësitë për përbushjen e rolit të DPET në mbëshitetje të institucioneve rajonale si dhe bizneseve e ekonomive lokale. Kjo gjë u realizua nga studimi i nevojave që ka tregu i punës për specialistë të kualifikuar në sektorin e Turizmit dhe hapja në kohë e këtij programi, kontribuoi për zgjidhje të menjëherëshme. Megjithatë, ky program duhet të përshtatet vazhdimisht me nevojat dhe kushtet më të përshtatshme.

### **Aktualisht DPET ka 3 programe studimi:**

- 1.“Bachelor” në Turizem, Cikli i parë, Kohë e plotë
- 2.“Master Profesional” në Turizëm, Cikli i dytë, Kohë e plotë
- 3.“Asistent – Menaxher në Shërbimet Turistike”, Program profesional, Kohë e plotë

### **Në të ardhmen do të punohet për hapjen e masterit shkencor në:**

- Guidator i guidave turistike (DPET, Departamenti i Gjeografisë dhe Departamenti i Historisë) Ndërsa, në kuadër të programeve të formimit të vazduar do të punohet për t'u hapur:
- Kurs 3 mujor për trajnimin e agjencive turistike

## **MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT**

Procesi mësimor kërkon që në kuadrin e përmirësimit të cilësisë së të mësuarit të realizohen disa objektiva si:

- Modernizimi i metodave dhe teknologjive të mësimdhënieς;
- Përditësimi dhe pasurimi i përbajtjes së programeve mësimore;
- Përmirësimi i kurrikulave;
- Rrita e pjesëmarrjes së studentëve në punën kërkimore-shkencore;
- Përmirësimi i cilësisë së praktikave profesionale.



### **Veprimet që do të ndërmerren:**

- Do të evidentohen nevojat për trajnime të personelit akademik.
- Do të ofrohen shkëmbime afatshkurtra të personelit akademik me universitete të huaja me të cilat Universiteti i Gjirokastres ka marrëdhënje bashkëpunimi.
- Do të vlerësohet reagimi i studentëve për metodat e mësimdhënies të pedagogëve me anë të anketimeve të herëpashershme.
- Do të vlerësohet dhe promovohet performanca pozitive e personelit akademik.
- Do të vazhdojë fitimi i gradave e titujve akademik nga anëtarët e departamentit.

### **Kufizimet që duhen përballuar:**

- Mungesa e pajisjeve të përshtatshme për një mësimdhënie moderne.
- Mungesat e fondeve e lehtësive për lëvizjen e lirë të stafit akademik për të kontaktuar, konsultuar, bashkëpunuar, shkëmbyer eksperiencia e përvoja me homologët nëpër botë.
- Mungesa e mjediseve të pranueshme të punës për stafin akademik e shkencor (mjedise, aparatura,etj).
- Mungesa e buxhetit finanziar per kryerjen e praktikës profesionale.

## **KËRKIMI DHE STUDIMET SHKENCORE**

### **Strategjia e DPET për kërkimin shkencor**

Aktiviteti në kuadrin kërkimor shkencor në DPET, zhvillohet në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë (Kreu VIII, Neni 93 “Kërkimi Shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë”).

DPET kryen veprimtari kërkimore-shkencore bazë ose të zbatuara, studime, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese në kuadër të FE dhe UGJ.

Nëpërmjet kësaj strategjie, DPET synon të jetë një *gendër expertise* dhe *ekselenca* në fushën e studimeve ekonomike. Gjithashtu, DPET synon:

- të përcaktojë prioritetet e kërkimit shkencor referuar përcaktimit të objektivave të veprimitarës kërkimore të çdo anëtarë të stafit akademik, duke synuar përputhjen e objektivave të kualifikimit shkencor individual me objektivat kërkimore-shkencore të njësise bazë, njësise kryesore dhe nevojave të zhvillimit rajonal;

- të rrisë standartin e kërkimit duke promovuar standartet më të larta në cilësinë e kërkimit si edhe integritetin etik në punën kërkimore;
- të orientojë kërkimin në të gjitha fushat dhe kategoritë që i përgjigjen zhvillimit social-ekonomik të rajonit;
- standardizojë “profilin e pedagogut” në përputhje me kërkesat e ligjit 80/2015 dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre;
- përfshijë studentët në kërkimin shkencor duke e konsideruar si mundësi “të artë” për të realizuar objektivat të kërkimit shkencor, si kërkesë për formimin e tyre profesional dhe orientimin e tyre në tregun e punës;
- zgjerojë partneritetin me çdo institucion, organizatë lokale, partnerë strategjikë, partnerë institucionalë, partnerë sipërmarrës etj, të cilët mund të ndihmojnë në përbushjen e misionit të tij, duke e konsideruar partneritetin si çelësin e suksesit;
- të përfshihet në sa më shumë projekte zhvilluese akademike e shkencore në kuadrin e projekteve europiane të arsimit të lartë, projekte që mbi të gjitha targetojnë zhvillimin e stafit akademik, mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve, aplikimin e standardeve europiane të cilësisë, organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta, përkthime e botime akademike e pedagogjike nga autorë të njohur ndërkombëtarisht, pajisjen e mjediseve mësimore dhe laboratoreve, etj.

Këto synime, DPET përpinqet t'i realizojë nëpërmjet bashkëpunimit me partnerë të besueshëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Jetëzimi i Strategjisë 2020 - 2025 përbën një ndër synimet më të rëndësishme të departamentit tonë dhe për të vënë në jetë vizionin e tij studimor-kërkimor, DPET ka hartuar plane pune, informacione dhe raporte semestrale e vjetore, në përputhje me strategjinë e universitetit për kërkimin shkencor, prioritetet e MASR në fushën e kërkimit shkencor, prioritetet e rajonit për zhvillim, të cilat depozitohen pranë Dekanit të Fakultetit.

## **LIDHJET KOMUNITARE DHE KOMBËTARE**

DPET, krahas misionit të tij të parë, atë të edukimit, përpinqet të realizojë më sukses edhe dy misionet e tjera, kërkimin shkencor dhe atë të bashkëpunimit me sektorët publik e privat të rajonit përmes edukimit të vazhdueshëm dhe angazhimit social. Rritja e rolit të DPET në ndihmë të zhvillimit ekonomik dhe social, mund të realizohet me përbushjen e këtyre objektivave:



- Duke ofruar krahas mësimit edhe veprimitari të ndryshme praktike si konsulencë, kërkim shkencor të aplikuar dhe shërbime të tjera, duke përfshuar në këtë mënyrë të ardhura shtesë. Klientët potencialë për këto shërbime do të jenë komunitetet dhe bizneset lokale, organet e qeverisjes vendore e qëndrore si dhe organizata të ndryshme donatore.
- Duke krijuar lidhje të forta me komunitetin lokal dhe duke treguar vëmendje të veçantë ndaj nevojave të këtij komuniteti.
- Duke bashkëpunuar efektivisht me Prefekturën, Qarkun, Bashkitë, drejtoritë dhe agjencitë e ndryshme rjonale, OJF-të e ndryshme etj. në funksion të reflektimit të punës së departamentit në interes të komunitetit.
- Duke siguruar bashkëpunime për të zgjidhur një sërë problemesh të rajonit që e shqetësojnë.
- Duke shërbyer si qendër e kualifikimit të ekonomistëve, sipërmarrësve etj, të rajonit.
- Duke inkurajuar partneritetin dhe integrimin e të rinjve në komunitet për gjetjen e alternativave që do të mundësojnë kohezionin social dhe zhvillimin e qëndrueshëm;

**b- Veprimet që do të ndërmerrin:**

- Organizimi i work-shopeve me komunitetin (sipas tematikave e rastit).
- Organizimi i konferencave të shtypit dhe tryezave të rrumbullakta.
- Ngritura e një komiteti ronal të politikave të zhvillimit me intelektualët e njohur të rajonit.
- Trajnimë në funksion të sektorit privat në rajon dhe tregut të punës.
- Hartimi dhe zbatimi i projekteve dhe studimeve të përbashkëta.
- Nxjerra dhe krijuimi i një aleance të sukseshme midis aktorëve kryesorë në rajon.
- Afrimi i komunitetit të biznesit me botën akademike, duke ofruar konsulencë dhe shërbime të drejtpërdrejta për komunitetin e biznesit, veçanërisht ato që lidhen me zhvillimin e SME-ve, zhvillimin, inovacionin si dhe ekonominë e bazuar në dije.

## ANALIZA SWOT

### PIKAT E FORTA

- Kualifikimi i kënaqshëm shkencor e pedagogjik i stafit tonë akademik.
- Arritjet e deritanishme nga stafi akademik si në fushën akademike dhe në atë shkencore (studime, botime, projekte, etj.,etj..)
- Ekzistenza e një sërë lidhjesh dhe raportesh pune me homologët tanë brenda që janë jashtë vendit.



## **PIKAT E DOBËTA**

- Mungesa e kontigjentit cilësor në pranimet e reja të studentëve.
- Mungesa e një baze materiale – laboratorike në nivelet e kërkuara nga koha.
- Tradita shume e re krahasuar me homologët.

## **OPORTUNITETET**

- Karakteristikat e zonës dhe rajonit ku ushtrohet aktiviteti universitar.
- Ekzistenza e resurseve njerëzore e materiale të aftë për një punë të kualifikuar.
- Specialistë të kualifikuar që mund bashkëpunojnë në shërbim të komunitetit dhe sipërmarrjes.
- Nevojat shumëplanëshe të ekonomise rajonale.
- Interesat shumëpalëshe të zonës dhe universitetit tonë.

## **KËRCËNIMET**

- Mungesa e mjeteve të duhura financiare për mbështetjen e punës kërkimore –shkencore në nivele bashkëkohore.
- Buxheti nuk administrohet duke u shpërndarë deri në njësitë bazë (Departamentet) ku paraqiten nevojat konkrete.
- Rrudhja e poullsisë në rajonin jugor si pasojë e emigracionit dhe largimit të të rinjve drejt qendrave të mëdha urbane.
- Problematikat që kalon në përgjithësi aktualisht shoqëria jonë.
- Konkurenca e pabarabartë me homologët.
- Hapja e Universiteteve dhe programeve të reja të studimit mbi bazën e gjykimeve jo profesionale dhe jashtë kritereve e parametrave të kërkuara duke ndikuar drejt për së drejti edhe në uljen e cilësisë se pranimeve në IAL.



Departamenti i Gjuhëve të Huaja (DGJH) realizon përgatitjen e mësuesve te gjuhës angleze dhe italiante me arsim të lartë për Arsimin e Mesëm të Ulët (arsimi 9-vjecar). Gjithashtu, që nga fillimet e veta ka mbuluar me stafin e vet akademik formimin e studentëve të të gjitha degëve të tjera të Universitetit "E.Cabej" që përgatiteshin si mësues për shkollat 9-vjecare të vendit me njohurite e domosdoshme ne gjuhen e huaj (anglisht,italisht,frengjisht).

Ne kuadrin e zhvillimeve te arsimit te larte ne perputhje me Marreveshjen e Bolonjes, stafi i DGJH mbulon lëndën gjuhe e huaj si ne programin e studimit Bachelor ashtu edhe ne Programet Master.

Stafi akademik i Departamentit përbëhet nga 11 anëtarë dhe një personel ndihmës akademik(laborant). Prej tyre dy (përgjegjësi i departamentit dhe përgjegjësi i gjë grupi mësimor-kërkimor) janë me titull të kategorisë "profesor" dhe pesë me gradën "doktor".

Departamenti i gjuheve te Huaja ka dy Grupe Mësimore Kërkimore

1) Grupi Mësimor Kërkimor i Letërsisë dhe Qytetërimit

2) Grupi Mësimor Kërkimor i Gjuhësisë teorike dhe i Gjuhësisë së zbatuar

Programet e studimit në Departamentin e Gjuhëve të Huaja janë tre:

Programi i studimit Bachelor në Gjuhë angleze, programi i studimit Master në AMU në Gjuhë angleze, programi i studimit Master në AMU në Gjuhë dhe Qytetërim italiano ndërsa programi i studimit Bachelor në Gjuhë italiante është bërë jo aktiv sepse ka mbi dy vjet që nuk hapet. Ato përshtaten plotësisht me strategjinë e zhvillimit të universitetit dhe fakultetit. Përbajtja e programeve të janë plotësisht në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në të gjitha komponentët dhe si i tillë është i miratuar nga ASCAL si dhe me kërkesat e shoqërisë dhe vendit përmes mësues të aftë në këtë hallkë të arsimit kombëtar.

Duke u mbështetur në objektivat e përcaktuara në strategjinë e zhvillimit të Universitetit, DGJH gjatë këtyre viteve e ka përqendruar punën mësimore e shkencore në drejtimet e mëposhtme:

- Ristrukturimi dhe përmirësimi i planeve mësimore, programeve mësimore përmes gjitha ciklet dhe format e studimit, si edhe i dokumentacionit universitar në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe ndryshimeve që janë bërë në Rregulloren dhe Statutin e Universitetit .



- Modernizimi i metodave dhe teknologjive të mësimdhënies dhe mësimnxënies, me synim rritjen e cilësisë së tyre.
- Përditësimi dhe pasurimi i përbajtjes së programeve mësimore, ligjëratave dhe seancave praktike me të rejet bashkëkohore të shkencës.
- Realizimi në mënyrë sa më cilësore i praktikave profesionale(pasive dhe aktive) dhe praktikave në terren të studentëve.
- Kualifikimi individual profesional dhe shkencor i stafit akademik.
- Pjesëmarrja në aktivitete kërkimore-shkencore kombëtare e ndërkombëtare.

Nga ana e GVB është konstatuar se per gjithesht veprimtaria mësimore e DGJH gjatë këtyre viteve është karakterizuar nga përpjekje intensive e të vazhdueshme të stafit akademik për të instaluar metoda e forma bashkëkohore për transmetimin dhe përvetësimin e dijeve në mënyrë që studentët të zhvillojnë ato shprehi e kompetenca që iu duhen për të ardhmen.

Një gjë e tillë pasqyrohet në të gjithë elementët e procesit mësimor :

- Planet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore.
- Dokumentacionin përkatës në përputhje me kërkesat e udhëzimet e MASR-it dhe rregulloreve të Universitetit, Fakulteteve dhe programeve përkatës të studimit.
- Oraret e mësimeve dhe struktura e vitit akademik për të dy ciklet dhe format e studimeve, me kohë të plotë prane ketij departamenti dhe me kohë të pjesshme prane departamenteve(qe e kane kete forme studimi)ku ne japid lenden gjuhe e huaj .
- Shpërndarja e disiplinave mësimore dhe e mësimdhënies së normuar vjetore.
- Në plotësimin e Departamenti me stafin akademik të nevojshëm.
- Ne punen e cdo pedagogu per te hartuar planet kalendarike mbi bazën e planit dhe programit mësimor dhe përpjekjet maksimale për realizimin sasior dhe cilësor të procesit mësimor.
- Ne kujdesin qe është treguar edhe për përditësimin e pasurimin e ligjëratave me të rejet bashkëkohore të shkencës,në përdorimin e metodave dhe teknologjive bashkëkohore në mësimdhënësie, si dhe për aplikimin e metodave rezultative për kontrollin e dijeve.
- Ne perpjekjet e të gjithë pedagogëve në vazhdimësi për t'i pajisur studentët me materiale të shkruara, si tekste apo cikël leksionesh në formë



dispencash në lëndët përkatëse. (*Në pothuajse të gjitha disiplinat studentët kanë tekste bazë apo cikle leksionesh të shtypura*).

Objektivat e strategjisë së Departamentit të DGJH, përmblidhen në tri drejtime bazë: a- atë akademike, b-kërkimi shkencor dhe c- marrëdhëniet me komunitetin

**Konkretisht realizimi i këtyre drejtimeve synohet të arrihet nëpërmjet:**

- a. kualifikimit të vazhdueshëm të stafit akademik. (Brenda vitit 2025 stafi do të jetë i plotësuar me grada dhe tituj shkencorë);
- b. përmirësimit të përbajtjës së kurrikalave të programeve të studimit që aplikon Departamenti, në përshtatje me nevojat e zhvillimit të arsimit në gjuhë të huaj dhe nevojave të tregut të punës në përgjithësi.
- c. rritjes së punës kërkimore shkencore në funksion të përmirësimit të performancës akademike të stafit akademik të Departamentit.
- d. krijimit të mundësive per realizimin efektiv të formave të studimit për gjatë gjithë jetës.
- e. pasurimit dhe përditësimit të bibliografisë së aplikuar në programet e studimit dhe të arritjeve të fushës në aspektin ndërkombëtar.
- f. rritjes së kërkesave për aplikimin e këtyre arritjeve në terrenin praktik.
- h. pjesëmarrjës së stafit akademik nëpër projekte kombëtare dhe ndërkombëtare që ndihmojnë në aftësimin profesional, pasurimin bibliografik, përdorimin e teknologjisë së përparuar në mësimdhënie dhe punë shkencore akademike

Garanci për realizimin e tyre përbën përvoja 26 vjeçare e Departamentit dhe angazhimi e përkushtimi i stafit akademik.

**Mundësime që ndihmojnë në zhvillimin e programeve të studimit**


- Shtimi i kapaciteteve botuese dhe kualifikimi e përvoja në rritje e pedagogëve krijojnë mundësi që disa lëndë teorike t'u ofrohen studentëve me cikle leksionesh te shtypura sepse dihet qe ne degen tonre kryesisht punohet me tekste bashkekohore te botuara ne perendim.
- Se shpejti do te jete kriuar dhe do te përfundojë plotësisht funksionimi i sistemit elektronik i dhënes së rezultateve të provimeve studentëve.
- Rikontruksioni i pritshëm i një ndërtese të marrë në pronësi nga UGJ do të krijojë mundësi edhe për shtimin e mjediseve mësimore dhe të punës edhe për DGJH.

**Pengesa në zhvillimin e programeve të studimit**



- Ndryshimet e shpeshta si dhe boshillëqet në kuadrin ligjor dhe udhëzimet e Ministrisë ndikojnë në vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e mbarëvajtjes së programit.
- E gjelje me vend te ngreme edhe një problem tjeter i cili ka impakt te drejtperdrejtë ne punen dhe ngarkesen e pedagogeve ne departamentintone. Keshtu ndryshimet e shpeshta te programeve me efekt pakesimin e oreve te gjuheve te huaja nga ana e departamenteve te tjera ne perqigje te udhezimeve te herepashershme te Ministrise se Arsimit,kane demtuar se tepermi mundesine e rritjes se nivelit te pervetesimit te gjuheve te huaja gje qe bie ne kundershtim me kerkesen per mbrojtje te gjuhes se huaj nga ana e tyre ne perfundim te studimeve te tyre dhe ku niveli i kerkuar ne gjuhe te huaj eshte jo i ulet, por B2.
- Mosjetja ende e strategjive dhe rrugëve në nivel shtetëror për të nxitur dhe motivuar nxënësit e mirë të ndjekin studimet në programet e mësuesisë bën që cilësia e kandidatëve në këto degë të jetë e ulët.
- Shtimi i viteve të arsimimit për të filluar punën si mësues i arsimit 9-vjecar (3 vjet bachelor + 2 vjet Master + stazh dhe provim shteti, pra gati 6-7 vjet?!) pakëson numrin e kandidatëve për të vazhduar këtë program studimi. Arsyet që lidhen me migrimin e popullsisë, hapja e universiteteve të shumta publike si edhe thithja e kandidatëve për studentë nga universitete perendimore ka bërë qënumri i studenteve që ndjekin programet e Departamentit të bjerë ndjeshëm.
- Mungesa e mjeteve te duhura financiare per mbeshtetjen e punes kerkimore – shkencore ne nivele bashkëkohore.





Gjirokastër, më 04.04.2019

**Lënda:** Vendim Departamenti për aprovin e Strategjisë së tij për periudhën 2020-2025.

**V E N D I M**

datë 04.04.2019

Trupa e Departamentit të Gjuhëve të huaja, e mbledhur sot, me datë 04.04.2019, pasi u njoh me draftin e Strategjisë së Departamentit dhe pasi diskutoi për çështje të veçanta të përbajtjes, vendosi aprovin e saj.

Përgjegjësi i Departamentit  
Prof. asoc. Harallamb Miçoni

